

I nderuar z. Matlija

Ju falënderojmë për komunikimin dhe ju urojmë nisjen e një viti të mbarë pune!

Angazhimi juaj për t'i shërbyer publikut lidhur me transparencën e institucioneve përputhet me misionin tonë si Agjenci.

Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi shpenzimet për bileta avioni dhe akomodim për udhëtimet jashtë shtetit të realizuara gjatë periudhës 01.01.2025 – 23.12.2025 nga përfaqësues të ministrive dhe të Kryeministrit, si dhe mbi destinacionet, personat pjesëmarrës dhe aktivitetet në të cilat kanë marrë pjesë, ju bëjmë me dije sa vijon:

Agjencia për Media dhe Informim (MIA) nuk disponon informacion të detajuar financiar apo administrativ lidhur me proceset e prenotimit të biletave të udhëtimit, akomodimit, kostot përkatëse, destinacionet konkrete, listat e punonjësve pjesëmarrës apo axhendat dhe aktivitetet specifike të zhvilluara jashtë vendit nga ministrinë apo nga Kryeministria. Këto të dhëna administrohen drejtpërdrejt nga institucionet përkatëse, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore dhe me fushat që ato mbulojnë.

Roli dhe funksioni i MIA-s, i cili ka të bëjë me koordinimin dhe komunikimin publik të veprimtarisë institucionale, nuk përfshin administrimin e dokumentacionit financiar, logjistik apo të agjendave zyrtare të udhëtimeve të ministrive apo institucioneve të tjera të linjës.

Për këtë arsye, për një informacion të plotë, të detajuar dhe zyrtar sipas elementeve të kërkuara në kërkesën tuaj, ju sugjerojmë t'i drejtoheni drejtpërdrejt institucioneve dhe ministrive përkatëse, të cilat janë autoritetet kompetente për vënien në dispozicion të këtyre të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, mbetemi në dispozicion për çdo sqarim shtesë brenda fushës së kompetencave të Agjencisë.

Me respekt

Elona Sinaj

Koordinatorë për të drejtën e Informimit